



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 78

2003

Shtator

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9110 datë 24.7.2003	Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda.....	3487
Ligj nr.9111 datë 24.7.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".....	3491
Ligj nr.9112 datë 24.7.2003	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë".....	3492
Ligj nr.9113 datë 24.7.2003	Për ratifikimin e "Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për drejtimin e stërvitjeve ushtarake e të trajnimeve dhe për dispozitat e mbështetjes së vendit pritës".....	3496
Ligj nr.9114 datë 24.7.2003	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.....	3506

Ligj nr.9115 datë 24.7.2003	Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura.....	3508
Ligj nr.9116 datë 24.7.2003	Për faljen e gjobave dhe të interesave për detyrimet tatimore të TVSH-së, të pashlyera nga kontraktorët e projekteve të financuara nga programi “PHARE”.....	3517
Ligj nr.9117 datë 24.7.2003	Për përcaktimin e formës. dhe të strukturës së formulës së privatizimit të "ARMO" sh.a., Fier.....	3518
Ligj nr.9119 datë 24.7.2003	Për disa ndryshime në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", ndryshuar me ligjin nr.7813, datë 14.4.1994, ligjin nr.7927, datë 24.4.1995 dhe ligjin nr. 8343, datë 6.5.1998.....	3520
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt "Sistemim, asfaltim rruge qendër qyteti në drejtim të varrezave, sistemim, asfaltim rruge midis dy shkollave, vendosje lapidarit të luftës ANÇ në Bashkinë Bilisht".....	3521

L I G J
Nr.9110, datë 24.7.2003

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATAVE
PËR KRIME TË RËNDA

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 e pika 2 shkronja "a", 83 pika 1, si dhe 135 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda, me synim rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, si dhe përmirësimin e cilësisë së gjyqimit të tyre.

Neni 2
Organizimi i gjykatave për krimet e rënda

1. Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda dhe gjykatave të apelit për krime të rënda zbatohen dispozitat ligjore lidhur me organizimin e pushtetit gjyqësor dhe ato për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.

2. Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda janë hallka të sistemit gjyqësor, që shqyrtojnë në shkallë të parë dhe të dytë krimet me rrezikshmëri të lartë, të caktuara me ligj.

3. Numri i gjykatave për krime të rënda, i gjykatave të apelit për krime të rënda, i gjyqtarëve të tyre, si dhe kompetenca tokësore e tyre caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, pasi të jetë marrë mendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 3
Përbërja

1. Gjykata për krime të rënda përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe gjyqtarët, të emëruar për një periudhë 9-vjeçare.

2. Kandidaturat për vendet vakante në gjykatat për krime të rënda dhe në gjykatat e apelit për krime të rënda, shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe vendimi për t'i propozuar Presidentit të Republikës emërimin e tyre, merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këtij Këshilli.

3. Me kërkesën e tyre dhe propozimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda, mund të riemërohen në këtë detyrë.

4. Pavarësisht nga mbarimi i mandatit 9-vjeçar, gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda, qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tyre.

5. Në mbarim të mandatit, me kërkesën e tyre gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda kanë të drejtë të emërohen:

- a) në funksionin gjyqësor të mëparshëm;
- b) në vendet vakante të gjykatave të tjera të sistemit gjyqësor, duke gëzuar përparësi ndaj kandidatëve të tjerë.

6. Gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda, vazhdojnë të përfitojnë pagën dhe përfitimet e tjera edhe pas përfundimit të afatit 9-vjeçar të mandatit të tyre në këto gjykata, kur vazhdojnë të kryejnë detyra në sistemin gjyqësor.

7. Pagën dhe përfitimet e tjera, sipas pikës 6 të këtij neni, e gëzojnë edhe gjyqtarët që, për

motive të arsyeshme, largohen nga detyra përpara afatit 9-vjeçar, me kusht që largimi të mos jetë rezultat i procedimit disiplinor ndaj tyre. Në çdo rast, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas rrethanave konkrete, mund të vendosë disa kushte apo kufizime në gëzimin e mëtejshëm të pagës dhe përfitimeve të tjera, përkatësisht, të gjyqtarit të gjykatës për krime të rënda ose të gjykatës së apelit për krime të rënda.

Neni 4

Kriteret e emërimit të gjyqtarëve

1. Emërimi i gjyqtarëve të gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda bëhet sipas kushteve të caktuara në nenin 24 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor".

2. Nuk mund të konkurrojnë për vendet vakante të gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda, personat që janë larguar nga detyra e gjyqtarit me masë disiplinore.

3. Gjyqtarët ndaj të cilëve janë dhënë masa të tjera disiplinore nga ajo e treguar në pikën 2 të këtij neni, mund të konkurrojnë vetëm pasi të kenë kaluar dy vjet nga data e shlyerjes së tyre.

Neni 5

Kompetencat e gjykatave për krime të rënda

1. Gjykata për krime të rënda dhe gjykata e apelit për krime të rënda gjykojnë në shkallë të parë dhe në shkallë të dytë veprat penale të parashikuara nga neni 75 shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale.

2. Kur gjatë gjykimit ndryshohet cilësimi ligjor i veprës penale dhe për këtë shkak kompetente është një gjykatë tjetër, gjykimi vazhdon dhe përfundohet nga gjykata e krimeve të rënda, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Gjykata për krime të rënda dhe gjykata e apelit për krime të rënda shqyrtojnë kërkesat dhe ankesat e palëve, të bëra gjatë hetimeve paraprake për çështjet në kompetencë të tyre. Caktimi dhe vlerësimi i masës së sigurimit për rastet e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të dyshuarit për një krim, mund të bëhen nga gjyqtari i gjykatës së rrethit gjyqësor ku ka ndodhur vepra penale ose ku është kryer ndalimi.

Neni 6

Përbërja e trupit gjykues

1. Gjykata për krime të rënda dhe gjykata e apelit për krime të rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë.

2. Kur për shkaqe objektive ose pengesë ligjore nuk mund të formohet trupi gjykues, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, mbi kërkesën e kryetarit të gjykatës, cakton për të plotësuar trupin gjykues gjyqtarë të gjykatave të tjera për krime të rënda, të gjykatave të apelit për krime të rënda, si dhe gjyqtarë të gjykatave të tjera, me kusht që të plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 4 pika 1 të këtij ligji.

Neni 7

Rregulla të veçanta procedurale

1. Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda zbatojnë rregullat e caktuara në Kodin e Procedurës Penale, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në ligj.

2. Përveç rasteve të parashikuara në nenin 340 të Kodit të Procedurës Penale, gjykimi i çështjeve nga gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda bëhet me dyer të mbyllura edhe kur një gjë e tillë çmohet e domosdoshme për çështjen që gjykohet ose për procedime të tjera, në interes të sigurimit kombëtar, rendit publik, të drejtësisë dhe të mbrojtjes së pjesëmarrësve në proces.

3. Në raste të veçanta, kryesisht ose mbi kërkesën e palëve, gjykata mund të vendosë

zhvillimin e seancave në mjedise të tjera që ndodhen jashtë atyre të veprimtarisë normale të saj.

4. Në raste të veçanta, me kërkesë të motivuar të Prokurorit të Përgjithshëm, çështja mund të transferohet në një gjykatë tjetër për krime të rënda, me vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Neni 8

Pyetja e dëshmitarëve

Gjykata për krime të rënda dhe gjykata e apelit për krime të rënda mund të lejojnë që pyetja e dëshmitarit, si dhe ballafaqimet dhe leximet e lejueshme të bëhen duke zbatuar, bashkërisht ose veçmas, rregullat vijuese:

- a) në praninë e të pandehurit dhe mbrojtësit, por pa kontakt vizual;
- b) pa i komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit identitetin e dëshmitarit;
- c) në raste dhe mënyra të tjera të caktuara, sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Neni 9

Të drejtat dhe garancitë e gjyqtarëve

Përveç të drejtave dhe garancive të njohura me ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", gjyqtarët e gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda gëzojnë edhe këto të drejta e garanci:

- a) pagë të veçantë, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij ligji;
- b) shpërblim të posaçëm mbi pagë të barabartë me një pagë mujore për periudhën e lejes;
- c) mbrojtje të veçantë personale, familjare dhe pasurore, si dhe ruajtje e afërt fizike, në mënyrën e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore.

Neni 10

Akte nënligjore

Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, pasi të ketë marrë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme lidhur me sigurimin e ruajtjen e posaçme të mjediseve të punës, ruajtjen e afërt fizike, mbrojtjen familjare dhe pasurore, si dhe të masave të tjera që lidhen me mbrojtjen e posaçme të gjykatave për krime të rënda, të gjykatave të apelit për krime të rënda, si dhe të gjyqtarëve të tyre.

Neni 11

Dispozita të fundit

1. Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda fillojnë funksionimin e tyre në datën 1 janar 2004.

2. Çështjet penale, që do të jenë në gjykim në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit deri në ditën e fillimit të funksionimit të gjykatave për krime të rënda, do të përfundohen nga këto gjykata.

3. Gjykatat për krime të rënda dhe gjykatat e apelit për krime të rënda sistemohen përkohësisht në mjedise të veçanta të gjykatave të vendit ku kanë qendrën, të cilat sigurohen në mënyrë të veçantë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Këshilli i Ministrave dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, sipas kompetencës së tyre, marrin masat për përmbushjen e detyrimeve përkatëse të parashikuara në ligj lidhur me fillimin në afatin e caktuar të veprimtarisë së gjykatave për krime të rënda dhe të gjykatave të apelit për krime të rënda.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3936, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Lidhja Nr.1

1. Sistemi i pagave për gjykatat për krimet e rënda:
 - a) kryetari i gjykatës - 70% e pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë;
 - b) zëvendëskryetari i gjykatës - 65% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë;
 - c) gjyqtar - 60% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë.
2. Sistemi i pagave për gjykatat e apelit për krimet e rënda:
 - a) kryetari i gjykatës - 90% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë;
 - b) zëvendëskryetari i gjykatës - 80% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë;
 - c) gjyqtar i apelit për krimet e rënda - 75% të pagës mujore të anëtarit të Gjykatës së Lartë.

L I G J
Nr.9111 datë 24.7.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8436, DATË 28.12.1998 "PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 81 pika 1 dhe pika 2 shkronja "a", si dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 10 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 28 bëhen këto shtesa:

- a) Në fund të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në këtë rast, gjyqtari përfiton një shtesë page prej 5 për qind mbi pagën, e cila përballohet nga gjykata ku ka emërimin.".

- b) Në fund të paragrafit të pestë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Në këtë rast, gjyqtari përfiton pagën përkatëse të detyrës së ngarkuar."

Neni 3

Në nenin 39 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në fund të nenit 39 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Gjyqtarët, që kryejnë detyra të ngutshme në ditët e pushimit javor ose të festave zyrtare, përfitojnë shtesë page në masën 50 për qind të pagës së tyre ditore."
b) Pas nenit 39 shtohen nenet 39/1 dhe 39/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 39/1

Pagat në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën ushtarake

1. Paga fillestare e gjyqtarit në gjykatën e rrethit gjyqësor dhe në gjykatën ushtarake është e barabartë me 50 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
2. Paga e zëvendëskryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës ushtarake është e barabartë me 57 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
3. Paga e kryetarit të gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës ushtarake është e barabartë me 60 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
4. Paga e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e barabartë me 65 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ajo e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Neni 39/2

Pagat në gjykatën e apelit

1. Paga fillestare e gjyqtarit në gjykatën e apelit është e barabartë me 70 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
2. Paga e zëvendëskryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 75 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
3. Paga e kryetarit të gjykatës së apelit është e barabartë me 80 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.
4. Paga e Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë është 80 për qind e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe ajo e Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë është e barabartë me 90 për qind të pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë."

Neni 4

Ligji nr.7800, datë 2.3.1994 "Për pagat e gjyqtarëve, ndihmësgjyqtarëve efektivë, prokurorëve dhe hetuesve", shfuqizohet.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet financiare të tij fillojnë që nga data 1 shtator 2003.

**Shpallur me dekret nr.3937, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9112, datë 24.7.2003

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.8678, DATË 14.5.2001 "PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E MINISTRISË SË DREJTËSISË"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 102 pika 4 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 3 e nenit 4 ndryshohet si më poshtë:

"3. Gjyqtarët dhe prokurorët mund të shërbejnë si këshilltarë ligjorë dhe në nivele drejtuese ose ekzekutive të strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë."

Neni 2

1. Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

"Ministria e Drejtësisë ushtron veprimtarinë e vet në fushat".

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

"6. Ndjek dhe realizon politikat dhe veprimtaritë, që lidhen me çështjet e përfaqjes dhe të integritetit të sistemit të drejtësisë në nismat dhe strukturat ndërkombëtare përkatëse, si dhe bashkërendon punën me institucionet e tjera, në funksion të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit Europian dhe të shteteve anëtare të tij."

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

"7. Kujdeset për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, që lidhen me sistemin gjyqësor dhe atë të drejtësisë, në përgjithësi."

4. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

"8. Kujdeset dhe kontrollon veprimtarinë e administratës gjyqësore."

5. Pika 17 ndryshohet si më poshtë:

"17. Kujdeset, drejton dhe kontrollon, sipas ligjit, shërbimet juridiko-administrative, që kanë lidhje ose realizohen në sistemin e drejtësisë."

6. Pika 18 ndryshohet si më poshtë:

"18. Kujdeset dhe mbështet, sipas ligjit, ushtrimin, organizimin dhe funksionimin e profesionit të avokatit, noterit, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë."

7. Pika 20 ndryshohet si më poshtë:

"20. Kujdeset për realizimin dhe bashkërendimin e veprimtarive në fushën e drejtësisë për të miturit, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, edukimin ligjor dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit nga ana e tyre, si dhe për ushtrimin e shërbimeve ndaj të miturve, nga strukturat përkatëse të sistemit të drejtësisë."

Neni 3

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit ushtron funksione dhe detyra që lidhen me fushat e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, të parashikuara në nenin 6 pikat 2, 3, 4, 5, 6, 16, 17, 20, 22, 24, 26, 27, 29 dhe 30 të këtij ligji. Për realizimin e funksioneve të saj, sipas fushave përkatëse, krijohen dhe funksionojnë drejtoritë vijuese:

- a) Drejtoria e Legjislacionit dhe e Asistencës Ligjore;
- b) Drejtoria e Integritimit dhe e Zhvillimit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- c) Drejtoria e Drejtësisë për të Miturit dhe e Shërbimeve Juridiko-Administrative."

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Drejtoria e Integritimit dhe e Zhvillimit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare ushtron këto veprimtari:

a) përgatit, ndjek dhe bashkërendon punët për realizimin e politikave, të programeve dhe raportimeve për integrimin e sistemit të drejtësisë në nismat dhe strukturat ndërkombëtare përkatëse, si dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e drejtësisë;

b) kujdeset dhe bashkërendon punën me institucione të tjera për realizimin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Komunitetit European dhe të shteteve anëtare të tij për fushën e drejtësisë;

c) përgatit materiale dhe studime krahasuese për zhvillimet në fushën e së drejtës ndërkombëtare dhe në atë të së drejtës shqiptare;

ç) ndjek dhe realizon procesin e studimit, të negociimit, nënshkrimit, miratimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, që i përkasin fushës së kompetencës të Ministrit të Drejtësisë;

d) kujdeset për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të kontakteve të Ministrisë së Drejtësisë me institucionet ndërkombëtare, institucionet homologe të shteteve të tjera, autoritetet gjyqësore të huaja, si dhe organizatat e tjera publike ose private të huaja;

dh) kujdeset dhe merr masa për organizimin, pjesëmarrjen dhe realizimin e shërbimeve të nevojshme për veprimtaritë ndërkombëtare në fushën e drejtësisë, brenda ose jashtë shtetit."

3. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Drejtoria e Drejtësisë për të Miturit dhe e Shërbimeve Juridiko-Administrative ushtron këto veprimtari:

a) përgatit, ndjek dhe bashkërendon realizimin e politikave, të programeve dhe veprimtarive që lidhen me fushën e drejtësisë për të miturit, edukimin ligjor, luftën dhe parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe kriminalitetit të të miturit;

b) kujdeset dhe bashkërendon punën me institucionet e ngarkuara me detyra ligjore për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të të miturve në fushën e drejtësisë, veçanërisht lidhur me birësimet dhe kujdestarinë e tyre;

c) kujdeset për zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit, që ngarkon Ministria e Drejtësisë dhe, në tërësi, organet e drejtësisë, me përmbushjen e shërbimeve të ndryshme juridiko-administrative."

Neni 4

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë i pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë ushtron funksione dhe detyra që lidhen me fushat e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, të parashikuara në nenin 6, pikat 7,8, 9, 10, 11, 15, 18, 19, 21, 25, 28 dhe 30 të këtij ligji. Për realizimin e funksioneve, sipas fushave përkatëse, krijohen dhe funksionojnë drejtoritë vijuese."

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Drejtoria e Profesioneve të Lira ushtron këto veprimtari:

a) ndjek dhe mbështet, sipas ligjit, ushtrimin e profesionit të avokatit, të noterit, arbitrit, ndërmjetësit, administratorit të falimentimit dhe profesioneve të tjera të lira, të lidhura me sistemin e drejtësisë, si dhe organizimin dhe funksionimin e këtyre profesioneve;

b) kujdeset dhe mbështet funksionimin e veprimtarisë dhe të shërbimeve të ekspertimeve ligjore, si dhe ndjek çështje të tjera, në përputhje me dispozitat përkatëse të akteve ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e tyre;

c) kujdeset për grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen e skedave dhe të regjistrit të gjendjes gjyqësore, si dhe për lëshimin e dëshmive përkatëse, në bazë të këtij regjistri."

Neni 5

Në nenin 12 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

"Drejtoria e Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar".

2. Shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) realizon dhe ndjek marrëdhëniet e Ministrisë së Drejtësisë me organet e sistemit të drejtësisë, në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar."

3. Paragrafi i fundit ndryshohet si më poshtë:

"Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave caktojnë kriteret dhe rregullat për përzgjedhjen e përkthyesve të jashtëm, tarifat e shpërblimit të tyre, si dhe rastet e tarifave të shërbimit të përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët, sipas shkronjave "c", "ç" dhe "d" të pikës 1 të këtij neni."

Neni 6

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 13

Drejtoria e Kontrollit Ekonomiko-Financiar

Drejtoria e Kontrollit Ekonomiko-Financiar ushtron veprimtaritë e mëposhtme:

a) realizon kontrollin ekonomiko-financiar të strukturave të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve në varësi të saj;

b) rekomandon masa ligjore dhe institucionale për përmirësimin e gjendjes dhe të praktikave, ekonomike dhe financiare, të veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve në varësi të saj;

c) ushtron kontrolle në veprimtarinë e strukturave të administratës gjyqësore për përmbushjen e detyrimeve ligjore, për të cilat ligji ngarkon me përgjegjësi Ministrinë e Drejtësisë;

ç) propozon, sipas ligjit, marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës për shkeljen e dispozitave ligjore, që lidhen me disiplinën ekonomiko-financiare;

d) bashkërendon veprimtarinë e saj me strukturat e tjera të specializuara të ekzekutivit në fushën e kontrollit të brendshëm administrativ dhe ekonomiko-financiar."

Neni 7

Shkronja "ë" e nenit 14 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 15

Drejtoria Ekonomike

Drejtoria Ekonomike ushtron veprimtaritë e mëposhtme:

a) ndjek dhe bashkërendon veprimtaritë e studimit dhe të përmbushjes së procedurave për hartimin e kërkesave buxhetore të Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve në varësi të saj;

b) merr masa, ndjek dhe raporton, sipas ligjit, për planifikimin, sigurimin dhe zbatimin e buxhetit të miratuar, për realizimin e fondeve financiare dhe të investimeve në fushat e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë dhe të institucioneve në varësi të saj."

Neni 9

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1
Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili, sipas ligjit, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e veprimtarive që lidhen me birësimet, për interesin e ligjshëm në mbrojtje të të drejtave të të miturve.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3938, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9113 datë 24.7.2003

**PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET QEVERISË
SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË BASHKUAR TË
BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT PËR DREJTIMIN E STËRVITJEVE
USHTARAKE E TË TRAJNIMEVE DHE PËR DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT
PRITËS"**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për drejtimin e stërvitjeve ushtarake e të trajnimeve dhe për dispozitat e mbështetjes së vendit pritës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3939, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË
SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT PËR DREJTIMIN E
STËRVITJEVE USHTARAKE TË TRAJNIMEVE DHE DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË
VENDIT PRITËS

Hyrje

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut (tani e në vazhdim të quajtura Pjesëmarrës):
duke marrë parasysh dispozitat e marrëveshjes ndërmjet pjesëmarrësve të Traktatit të

Atlantikut të Veriut për Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), i firmosur në Londër, më 19 qershor 1951 dhe marrëveshjes ndërmjet shteteve pjesëmarrëse në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe për statusin e forcave të tyre (PfP SOFA), të firmosur në Bruksel më 19 qershor 1995;

duke marrë në konsideratë konceptin e përfshirë në shpërndarjen e forcave të armatosura të Pjesëmarrësve në territorin e secilit vend për të zhvilluar stërvitje ushtarake dhe trajnime të miratuara nga të dy Pjesëmarrësit;

dhe duke marrë në konsideratë nevojat e forcave të armatosura të njërit Pjesëmarrës për mbështetjen e vendit pritës, kur ato shpërndahen në territorin e vendit tjetër;

kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1 Përkufizime

Në këtë Memorandum mirëkuptimi do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) "Forca vizitore", quhen forcat e armatosura të njërit Pjesëmarrës, kur vendosen në territorin e Pjesëmarrësit tjetër për qëllime stërvitjesh të miratuara nga të dy Pjesëmarrësit. Ky term përfshin personelin, anijet, avionët, automjetet, depot, pajisjet, municionet, raketat, së bashku me komponentët civilë të këtyre forcave, sipas përcaktimit të bërë në NATO SOFA, si dhe të gjitha burimet që transportohen nga ajri, deti dhe toka dhe shërbimet e tyre mbështetëse të kërkuara për shpërndarjen e forcave të përmendura më lart.

b) "Vendi pritës" quhet Pjesëmarrësi ose siç e kërkon konteksti, shteti i cili pret në territorin e tij përkohësisht forcat e Pjesëmarrësit tjetër gjatë stërvitjeve të miratuara në mënyrë dypjesëmarrëse.

c) "Mbështetja e vendit pritës (MVP)" quhet asistencë civile dhe ushtarake që i jepet nga njëri Pjesëmarrës forcave të Pjesëmarrësit tjetër gjatë stërvitjeve të miratuara nga të dy Pjesëmarrësit, kur zhvillohen në territorin e tij duke përfshirë atë ajror ose detar.

d) "Autoritete ushtarake" quhet zyra e caktuar ose formacioni ushtarak i forcave të armatosura i secilit Pjesëmarrës dhe e specifikuar, po të jetë e nevojshme në marrëveshjen zbatuese.

e) "Rajonet e trajnimit" janë ato rajone në vendin pritës të përcaktuara në planet e stërvitjes, ku forcat vizitore shpërndahen për të zhvilluar stërvitjen në fjalë.

f) "Stërvitjet dhe trajnime", ky term përfshin stërvitje dhe aktivitete trajnuese me njëpjesëmarrës, dypjesëmarrës dhe shumëpjesëmarrës duke përfshirë njësitë dhe individët, shkëmbime dhe atashime të njërive, por përjashton arsimimin e individëve në kurse.

g) "Masat zbatuese", quhen masat në vazhdim të kësaj Marrëveshjeje, të cilat përfundojnë për çdo stërvitje apo veprimtari trajnuese dhe detajojnë kërkesat e burimeve në dispozicion të forcave vizitore dhe vendit pritës në dispozicion për plotësimin e këtyre kërkesave. Në masat zbatuese gjithashtu detajohen procedurat e nevojshme që do të zbatohen nga Pjesëmarrësit për dispozitat e (MVP) dhe "kur është e nevojshme" për drejtimin e stërvitjes. Masat zbatuese janë një dokument plotësues i këtij Memorandumi të përfunduara ndërmjet pjesëmarrësve të ministrive të mbrojtjes dhe do të interpretohen në përputhje me dispozitat e tij.

Neni 2 Qëllimi dhe gama

1. Ky Memorandum ka si qëllim identifikimin e përgjegjësive dhe parimet e përgjithshme që lidhen me drejtimin e stërvitjeve dhe trajnimeve, si dhe dispozitat e MVP-së. Në Memorandum do të përshkruhen gjithashtu standardet, lloji, niveli dhe metodat e mbështetjes që vendi pritës u siguron forcave vizitore gjatë stërvitjes.

2. Në masat zbatuese përkatëse do të trajtohen procedurat e detajuara dhe kërkesat e përgjithshme për mbështetjen. Mbështetja e detajuar që miratohet për vendin e secilës stërvitjeje do të dokumentohet në shtojcat e masave zbatuese përkatëse.

3. Po të mos jetë deklaruar në këtë Memorandum, dispozitat për masat për MVP të përshkruara në këtë Memorandum do të zbatohen nga momenti i hyrjes së komponentëve fillestarë të forcave vizitore në territorin e vendit pritës dhe do të vazhdojnë deri kur këto forca të largojnë edhe komponentin e fundit nga territori i vendit pritës.

4. Ky Memorandum nuk synon të vihet në konflikt me ligjet e vendit pritës ose çdo

marrëveshje ndërkombëtare që mund të jetë në fuqi ndërmjet pjesëmarrësve dhe në rast konflikti do të paraprijnë dispozitat e këtij të fundit.

Neni 3

Dokumente të zbatueshme

1. Për çështjet e trajtuara në këtë Memorandum do të vihen në zbatim dokumentet e mëposhtme ose dokumente të tjera pasuese:

- a) NATO SOFA
- b) PfP SOFA
- c) Planet dhe instruksionet përkatëse të stërvitjes

2. Në dokumentet e NATO-s që mund t'i referohemi përcaktimit të masave zbatuese të pjesëmarrësve përfshihen dokumentet e mëposhtme, por nuk mund të kufizohemi vetëm në to:

- a) MC 319/1: Parimet dhe politikat e NATO-s për logjistikën;
- b) MC334/1: Parimet dhe politikat e NATO-s për mbështetjen e vendit pritës;
- c) AJP 4.5: Doktrinat dhe procedurat e bashkuara të aleatëve për vendet pritëse;
- d) C-M (2002) (49) 17 qershor 2002: Sigurimi brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.

3. Në Marrëveshjen e standardizimit të NATO-s (STANAG), e cila mund të udhëzojë përcaktimin e masave zbatuese të pjesëmarrësve do të përfshihen:

- a) STANAG 2034: Procedurat standarde të NATO-s për asistencën bilaterale logjistike (kryesisht STANAG 3381).
- b) STANAG 2061: Procedurat për zhvendosjen e pacientëve nga instalimet mjekësore.
- c) STANAG 2132: Dokumentacion që lidhet me evakuimin mjekësor, trajtimin dhe shkaqet e vdekjes së pacientëve.
- d) STANAG 3113: Dispozitat për mbështetjen e personelit vizitor, avionëve dhe automjeteve.
- e) STANAG 6012: Parimet dhe procedurat financiare, që lidhen me përdorimin e zonave të trajnimit dhe pajisjeve trajnuese.

Neni 4

Përgjegjësitë e vendit pritës

Vendi pritës brenda dispozitave të këtij Memorandumi:

a) Do të autorizojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar në përputhje me stërvitjen e miratuar dhe planet mbështetëse:

- 1. Pritjen e forcave vizitore në pikën e caktuar të hyrjes.
- 2. Lëvizjen përpara në rajonet e përcaktuara të trajnimit.
- 3. Drejtimin e stërvitjes ose veprimtarisë trajnuese.
- 4. Kthimin e forcave vizitore nga pikat e përcaktuara të largimit.

b) Do të autorizojë forcat vizitore të përdorin korridoret ajrore kombëtare të vendit pritës, sipas planeve të miratuara dhe procedurave kombëtare.

c) Do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar përdorimin e lehtësirave në porte dhe aeroporte, rrugë ajrore, detare dhe hekurudhore për të siguruar hyrjen, pritjen dhe shpërndarjen e forcave dhe furnizimeve, siç specifikohen në stërvitje ose në planet e trajnimit.

d) Do të autorizojë dhe marrë masat për furnizimin dhe përdorimin e burimeve të brendshme, duke përfshirë, po të kërkohet, edhe shërbimet nga burime tregtare, për të plotësuar kërkesat e forcave vizitore për furnizime dhe pajisje, përfshirë karburant, racione rezervë, pajisje, automjete, lehtësira komunikimi, lokale, shtrime në spital, punë dhe shërbime të tjera të specifikuara në masat zbatuese përkatëse.

e) Do të autorizojë, sipas një njoftimi, importimin, lëvizjen brenda dhe eksportimin nga territori i saj të materialeve, racioneve, armëve dhe municioneve sipas kërkesave të bëra nga forcat vizitore për drejtimin e stërvitjes dhe trajnimit, stërvitjen ose veprimtaritë trajnuese në fjalë dhe do të njoftojë forcat vizitore mbi kërkesat specifike për zhvillimin e importimit të sigurt brenda vendit, lëvizjet dhe eksportimin nga territori i saj të materialeve të rrezikshme, veçanërisht eksplozivëve dhe municioneve.

f) Do të ndihmojë në procedurat e nevojshme në dogana për stërvitjen ose veprimtaritë trajnuese në fjalë dhe do të njoftojë forcat vizitore mbi kërkesat specifike për zhvillimin e importimit të sigurt brenda vendit, lëvizjen dhe importimin nga territori i saj i materialeve të rrezikshme, veçanërisht eksplozivëve dhe municioneve.

g) Do të autorizojë personelin e forcave vizitore të mbajnë armët dhe municionin individual gjatë stërvitjes në kohën dhe vendin e përcaktuar ndërmjet autoriteteve ushtarake përkatëse të vendit pritës dhe komandantit të forcave vizitore.

h) Do të sigurojë ekipin ndërlidhës për shërbime këshilluese si përkthime dhe menaxhim të klerancave doganore, në rast se është specifikuar në masat zbatuese.

i) Do të sigurojë, sa të jetë e mundur, që standardi i mallrave dhe shërbimeve që i janë dhënë forcave vizitore të jetë i njëjtë me atë që i është ofruar personelit të tij ushtarak i të njëjtit rang ose klasifikim, po të mos jetë përcaktuar në mënyrë reciproke nga Pjesëmarrësit.

j) Do të sigurojë vlerësime të kostove për mallrat dhe shërbimet që do të jepen nga vendi pritës.

k) Do të autorizojë forcat vizitore të instalojnë matësa konsumi dhe pajisje kontrolli për mjete dhe shërbime, sipas kërkesave, me mirëkuptimin që këto matës dhe pajisje do të hiqen në fund të stërvitjes dhe forcat vizitore do të përgjigjen për çdo dëmtim që do t'i shkaktohet pajisjes së monitoruar me këto mjete.

l) Do t'i japë këshilla mbi rregullat e mjedisit që do të zbatohen gjatë stërvitjes, duke specifikuar në masat zbatuese përkatëse parimet dhe procedurat, që duhen ndjekur për mbrojtjen e mjedisit në rajonet e trajnimit.

Neni 5

Përgjegjësitë e forcave vizitore

Forcat vizitore, brenda dispozitave të këtij Memorandumi:

a) Do të drejtojnë stërvitjet dhe trajnimet me masat zbatuese përkatëse dhe do të përdorin lehtësirat e vendit pritës, në përputhje me procedurat e përcaktuara në ato masa zbatuese dhe me plane mbështetëse logjistike kombëtare, që plotësojnë këtë masë zbatuese.

b) Do t'u nënshtrohen dispozitave të seksionit 7 të këtij Memorandumi, do të rimbursojnë vendin pritës për të gjitha furnizimet dhe shërbimet e miratuara nga të dy Pjesëmarrësit dhe të ofruara nga autoritetet ushtarake të vendit pritës dhe do të ruajnë ata artikuj që janë dhënë për përdorim të përkohshëm. Çdo artikull i siguruar për përdorim të përkohshëm nga forcat vizitore do të përdoret me kujdes dhe do t'u kthehet autoriteteve ushtarake përkatëse të vendit pritës para largimit në të njëjtën gjendje, në të cilën ato u morën fillimisht, përveç veshjeve ose grisjeve që ndodhin gjatë përdorimit të përditshëm.

c) Do t'u nënshtrohen dispozitave të NATO SOFA, do të jenë në përputhje me procedurat dhe formalitetet doganore të vendit pritës.

d) Do të sigurojnë personelin ndërlidhës për të koordinuar të gjitha veprimet logjistike me autoritetet civile lokale, sipas kërkesave, dhe në pikat e hyrjes dhe të daljes.

e) Do të veprojnë në përputhje me rregullat dhe procedurat e mjedisit lidhur me stërvitjen ose veprimtarinë trajnuese, si dhe me të gjitha rregullat në fuqi në vendin pritës, lidhur me ruajtjen, transportimin, përdorimin, trajtimin dhe asgjësimin e materialeve dhe municioneve të rrezikshme.

f) Do të sigurohen se detajet e municioneve (p.sh. sasia neto e eksplozivit, lloj municionesh) që do të transportohen, të jenë deklaruar tek autoritetet ushtarake përkatëse të vendit pritës të paktën 30 ditë përpara vendosjes. Në këto detaje përfshihen emrat e pikave të hyrjes dhe të daljes nga ku municionet ose materialet e rrezikshme janë planifikuar të transportohen, destinacionin e tyre, si dhe datat e mbërritjes dhe të kthimit.

g) Do të respektojnë procedurat dhe masat e detajuara të përcaktuara në mënyrë të përbashkët në planet dhe udhëzimet përkatëse të stërvitjes, si dhe në masat zbatuese përkatëse për çështje administrative dhe të personelit, duke përfshirë p.sh. importimin e valutës, mbështetjen me përkthyes, operacionet e automjeteve, procedurat e raportimit dhe të rikthimit të personelit të sëmurë dhe marrëdhëniet publike për stërvitjen.

Neni 6

Përfshirja e vendeve të treta

1. Në rast se një Pjesëmarrës propozon përfshirjen në stërvitje ose veprimtari trajnuese të forcave të një pjesëmarrësi të tretë në territorin e Pjesëmarrësit tjetër të këtij Memorandumi, atëherë ky Pjesëmarrës do të njoftojë vendin pritës në mundësinë më të parë gjatë procesit të planizimit të stërvitjes, por ai vetë nuk do të jetë përgjegjës mbi masat dhe detyrimet për statusin e personelit të vendit të tretë në territorin e vendit pritës. Nëse vendi i tretë është ose jo pjesëmarrës në ndonjërin nga NATO ose PFP SOFA, do të jetë e nevojshme një masë rregulluese e veçantë ndërmjet vendit pritës dhe vendit të tretë. Në rast se një pjesëmarrës organizon ose merr pjesë në një trajnim ose stërvitje në territorin e një vendi të tretë dhe fiton aty forcat e pjesëmarrësit tjetër për të marrë pjesë në këtë veprimtari, kjo mund t'i ndihmojë këto forca, kur të jetë e mundur duke i siguruar elementë të caktuar të MVJ-së gjatë periudhës së aktivitetit. Ekzaktësisht natyra dhe lloji i mbështetjes do të përcaktohet në masat zbatuese për secilën stërvitje ose veprimtari trajnuese. Megjithatë Pjesëmarrësi organizator nuk do të përgjigjet për masat dhe detyrimet që lidhen me statusin e forcave të pjesëmarrësit tjetër në vendin e tretë të përfshirë.

Neni 7

Logjistika dhe financa

1. Për çdo mbështetje logjistike, furnizime ose shërbime, që nuk sigurohen falas nga konsensusi i përbashkët referuar STANAG 3113, autoritetet përkatëse të vendit pritës dhe forcave vizitore mund të negociojnë për pagesën në cash të specifikuar nga vendi pritës (një transaksion i rimbursueshëm, pagesa në natyrë) shkëmbim transaksioni ose pagesa në "vlerë të barabartë", e cila përcaktohet vetëm në termin monetary, si rezultat forcat vizitore do ta paguajnë vendin pritës në përputhje me dispozitat përkatëse për çdo lloj transaksioni të detajuar në nënparagrafët (a), (b) dhe (c) të përgatitura më poshtë, si dhe dispozitat më të përgjithshme të deklaruara në pjesën e mëposhtme të këtij seksioni.

a) Transaksionet e rimbursueshme. Forcat vizitore do të paguajnë bilancet e prapambetura jo më vonë se 60 ditë pas marrjes së faturave. Në vënien e çmimit të transaksioneve të rimbursueshme Pjesëmarrësit do të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme:

1. Përfaqësuesi përgjegjës i forcave vizitore dhe autoriteti i vendit pritës do të negociojnë çmimet duke mos përfshirë detyrimet që përjashtohen më poshtë.

2. Kur një çmim i përcaktuar nuk është negociuar përpara porosisë, porosia do të përcaktojë një kufizim maksimal të detyrimit për forcat vizitore, që do të porosisin mbështetjen logjistike, furnizimet ose shërbimet, negociatat në vazhdim për një çmim final. Autoritetet përkatëse të Pjesëmarrësve do të hyjnë menjëherë në negociatat për të vendosur një çmim përfundimtar, që sipas rrethanave të caktuara e kalon limitin maksimal fillestar të detyrimit. Barra e justifikimit të rritjes do të varet nga Pjesëmarrësi që kërkon të kalojë maksimumin. Kur autoritetet përkatëse të pjesëmarrësve kanë vështirësi në negociimet për çmimin përfundimtar, ato mund të marrin në konsideratë shkëmbimin në natyrë.

3. Për të mbuluar kostot e përgjithshme dhe administrative të paatribuara direkt për zonën e trajnimit dhe pajisjet e saj, vendi pritës mund të shtojë një detyrim shtesë prej 3% të faturës përfundimtare.

4. Kur llogaritë janë vendosur, asnjë Pjesëmarrës nuk merr ose ruan përfitime që rezultojnë nga transaksionet e vendosura.

5. Në rast blerjesh specifike të vendit pritës nga kontraktorët lokalë në emër të forcave vizitore, kostoja do të jetë jo më pak e favorshme sesa çmimi i caktuar i forcave të armatosura të vendit pritës për mbështetje të njëjtë, furnizime dhe shërbime më pak se çdo shumë, siç është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij seksioni. Megjithatë, çmimi i caktuar mund të marrë parasysh detyrimin diferencial p.sh. afatet e livrimit, pikat e shpërndarjes e të tjera të ngjashme me to.

6. Në rast transfertash nga burimet vetjake të vendit pritës, sasia e paguar për mbështetje logjistike nga forcat vizitore do të jetë e njëjtë me detyrimet që vendi pritës u vë forcave të tij të armatosura, sipas datës që është pranuar porosia.

b) Transaksionet e shkëmbimit. Forcat vizitore u paguajnë autoriteteve ushtarake të vendit

pritis në natyrë duke transferuar mbështetjen logjistike, furnizimet dhe shërbimet, të cilat janë të njëjta ose thelbësisht të njëjta me ato që janë livruar ose përdorur dhe plotësojnë nevojat sipas autoriteteve ushtarake të vendit pritës. Në rast se forcat vizitore nuk mund të paguajnë në natyrë brenda termave të një programi dërgimi në kohën e transaksionit origjinal, atëherë transaksioni me konsensus reciprok do të kërkohej të jetë transaksion i rimbursueshëm dhe kryhet sipas nënparagrafit (a) që është lart, por çmimi do të bazohet tek data në të cilën ishte planifikuar që të bëhej pagesa në natyrë.

c) Vlera e barabartë. Termi vlerë e barabartë nënkupton mbështetje logjistike, furnizime ose shërbime, të përcaktuara në terma monetare duke vënë në veprim çmime aktuale ose çmimet e përlllogaritura në kohën, kur është miratuar transaksioni. Forcat vizitore u paguajnë autoriteteve ushtarake të vendit pritës duke transferuar mbështetjen logjistike, furnizime dhe shërbime të barabarta në vlerë me ato që janë shpërndarë dhe që miratohen nga autoritetet ushtarake të vendit pritës. Në rast se forcat vizitore nuk paguajnë në "vlerë" brenda një programi shkëmbimi, brenda kohës së transaksionit origjinal të një kuadri kohor, që nuk i kalon të tre muajt nga data e transaksionit origjinal, atëherë ky transaksion do të vlerësohet si i rimbursueshëm dhe trajtohet sipas nënparagrafit (a) lart.

2. Në plotësimin e rolit të tyre koordinues për të lehtësuar punën për marrje furnizimesh nga burimet tregtare, autoritetet ushtarake të vendit pritës nuk do t'i marrin këto shërbime ose nuk do të kryejnë kontrata tregtare në emër të forcave vizitore pa marrë përpara konsensusin e këtyre të fundit se i kanë pranuar këto shërbime e furnizime, si dhe miratimin për të paguar koston e specifikuar për to. Të gjitha shërbimet dhe furnizimet nga burime tregtare bëhen mbi bazën e masave formale kontraktuale.

3. Si forcat vizitore dhe autoritetet e vendit pritës do të regjistrojnë të dhënat e të gjitha transaksioneve ndërmjet pjesëmarrësve.

4. Faturat për mbështetjen logjistike, furnizimet dhe shërbimet bazohen nga formulari standard i NATO-s për kërkesë, marrje dhe kthim ose faturë, i paraqitur në aneksin B të STANAG 2034 dhe i referohet këtij Memorandumi, si dhe çdo numri tjetër porosit. Faturat shoqërohen nga evidenca e dëftesave të marrjes nga forcat vizitore dhe do të zgjidhen ose përmes masave të detajuara, të cilat përshkruhen në masat zbatuese, ose u dërgohen autoriteteve ushtarake të forcave vizitore, jo më vonë se 60 ditë nga data kur këtyre forcave u është siguruar mbështetja logjistike, furnizimet dhe shërbimet. Faturat përcaktojnë sipas artikujve detyrimet për çdo mbështetje logjistike, furnizim ose shërbim që do të paguhet.

5. Forcat vizitore do të paguajnë për furnizime, pajisje ose shërbime nga burime komerciale si ushqime, qira për automjete dhe shërbime lavanderie përpara largimit nga territori i vendit pritës, në rast se nuk është përcaktuar në kontratë ose në rast se nuk ekziston ndonjë mosmarrëveshje lidhur me koston ose dëftesat e marrjes. Në rast se paraqiten këto situata, atëherë do të bëhet çdo përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjet sa më shpejt për të shpejtuar likuidimin e llogarisë.

6. Në varësi nga gjendja në magazinë, vendi pritës do t'i sigurojë personelit të forcave vizitore mensa dhe akomodim me të njëjtin nivel që do t'i sigurohej anëtarëve të forcave të vendit pritës.

7. Forcat vizitore nuk do t'i rriten për një vendi ose organizate tjetër mbështetjen logjistike, furnizimet dhe shërbimet, qoftë përkohësisht ose përgjithmonë, pa marrë miratimin me shkrim të vendit pritës.

8. Lidhur me ligjet ekzistuese, rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, autoritetet përkatëse të vendit pritës duhet të sigurohen se taksat, detyrimet doganore, detyrime të tjera të ngjashme nuk do të vihen në lidhje me këtë Memorandum.

9. Në masat zbatuese përkatëse do të specifikohen sipas rasteve masa më të detajuara financiare duke përfshirë edhe ato për likuidimin e llogarisë.

Neni 8

Disiplina dhe juridiksioni

1. Masat për juridiksionin, që do të zbatohen për personelin e forcave vizitore, do të jenë siç përshkruhen në nenin 7 të NATO SOFA.

2. Në rast se ndonjë personel i forcave vizitore është marrë në arrest nga autoritetet e vendit pritës, duhet të njoftohet menjëherë stafi drejtues i stërvitjes ose trajnimit, si dhe përfaqësuesit e lartë pjesëmarrës në stërvitje të vendit pritës dhe forcave vizitore. Ata nga ana e tyre do të njoftojnë pastaj autoritetet e caktuara ushtarake.

3. Në rastet kur, në përputhje me nenin 7 të NATO SOFA, autoritetet e vendit pritës kanë të drejtë të ushtrojnë juridiksion mbi anëtarët e forcave vizitore, ky juridiksion do të ushtrohet brenda sistemit të drejtësisë kriminalistike, i zbatueshëm për civilët dhe nuk do të ushtrohet për anëtarët e forcave të armatosura të vendit pritës.

Neni 9

Komanda dhe kontrolli

1. Masat për komandën dhe kontrollin do të bëhen në përputhje me planet kombëtare dhe procedurat ose planet dhe procedurat e përcaktuara ndërmjet pjesëmarrësve, sipas rastit për stërvitje dhe aktivitete të përfshira dhe të detajuara në masat zbatuese përkatëse.

2. Në rast armiqësish, të shoqëruar ose jo me një deklaram lufte, personeli i forcave vizitore nuk do të përfshihet në operacione aktive në asnjë rol dhe do të ndihmohet nga vendi pritës për të kërkuar udhëzime nga qeveria e tyre.

Neni 10

Ankesa dhe detyrime

1. Ankesat që rrjedhin brenda ose jashtë zbatimit të këtij Memorandumi do të trajtohen nga vendi pritës në përputhje me nenin 8 të NATO SOFA. Masa specifike administrative do të përfshihen në masa zbatuese përkatëse.

2. Ankesat që rrjedhin nga veprimtari të ndërmarra në lidhje me këtë Memorandum, ku neni 8 i NATO SOFA nuk mund të zbatohet, do të vazhdojnë nga personat përkatës të Pjesëmarrësve, siç vendoset nga konsultimet ndërmjet pjesëmarrësve dhe do të shënohet në masat zbatuese përkatëse.

3. Në rast dëmtimesh të shkaktuara pronës së përbashkët të Pjesëmarrësve, ku kostot e zhdëmtimit nuk mbulohen nga një palë e tretë, kjo kosto do të ndahet në mënyrë të barabartë nga Pjesëmarrësit.

4. Pjesëmarrësit nuk zhdëmtojnë kontraktorët ndaj ankesave dhe detyrimeve të palës së tretë.

Neni 11

Mbrojtja dhe sugjerimi i informacionit të klasifikuar

1. I gjithë informacioni i klasifikuar i shpërndarë ose i shkëmbyer në funksion të këtij Memorandumi do të përdoret, transmetohet, ruhet, trajtohet dhe mbrohet në përputhje me ligjet dhe rregullat kombëtare të sigurimit të pjesëmarrësve.

2. Informacioni i klasifikuar do të transferohet vetëm përmes kanaleve të qeverive ose kanaleve të miratuara nga autoritetet e caktuara të sigurisë së vendeve Pjesëmarrëse. Ky informacion do të përmbajë nivelin e klasifikimit dhe vendin e origjinës.

3. Çdo Pjesëmarrës do të ndërmarrë të gjitha hapat ligjore për të siguruar se informacioni i klasifikuar i shpërndarë për qëllime të këtij Memorandumi është i mbrojtur nga dalja e sekretit, në rast se nuk ka marrë miratimin e palës tjetër që ky sekret të dalë.

4. Çdo Pjesëmarrës duhet të sigurohet që futja në informacionin e klasifikuar është e kufizuar për ata persona, që kanë klerancën e kërkuar të sigurisë dhe kanë nevojë specifike për të hyrë në informacionin e klasifikuar që të marrin pjesë në stërvitje.

5. Vendi pritës duhet të sigurohet se trajnimi zhvillohet pa ndërhyrje nga ndërhyrje të personelit të paautorizuar, që shkel në rajonet e trajnimit, poligone ose rajone mbështetëse të stërvitjes.

6. Procedurat e detajuara të sigurisë do të specifikohen në masat zbatuese përkatëse.

Neni 12

Trajtimi mjekësor dhe dentar

1. Komandanti i forcave vizitore përgjigjet për të siguruar se personeli i forcave vizitore është i përshtatshëm nga ana shëndetësore dhe mjekësore që para fillimit të pjesëmarrjes në stërvitjen ose

veprimtarinë në fjalë. Personeli i forcave vizitore do të dislokohet me gjithë sasinë e nevojshme të medikamenteve të parashikuara për periudhën e dislokimit, duke siguruar që ai ka një trajtim të nevojshëm për gjithë këtë periudhë.

2. Trajtimi mjekësor dhe dentar do të sigurohet nga vendi pritës në përputhje me nenin 9 të NATO SOFA. Gjithashtu personeli i forcave vizitore duhet të ketë siguracionin e nevojshëm shëndetësor, kur ndërmerr veprimtari që nuk janë pjesë e trajnimit të tyre të autorizuar.

3. Mbështetja mjekësore dhe dentare e dhënë për forcat vizitore pjesëmarrëse në stërvitje përcaktohet në masat zbatuese përkatëse, ku identifikohet vendndodhja dhe lloji i shërbimeve mjekësore në dispozicion në afërsi të rajonit të planifikuar të trajnimit.

4. Autoritetet e vendit pritës sigurohen sa më shumë të jetë e mundur se avionëve dhe helikopterëve të forcave vizitore MEDEVAC do t'u jepet e drejta, prioritet i lartë për të kaluar brenda dhe jashtë rajonit të caktuar të trajnimit dhe do t'u jepet e drejta për të hyrë në hapësirën ajrore të vendit pritës, për të plotësuar misione emergjence, në përputhje me procedurat e tij kombëtare.

5. Dispozitat e STANAG 2061 dhe STANAG 2132 mund të përdoren si udhëzues në zbatimin e këtij Memorandumi.

6. Trajtimi mjekësor bazë dhe trajtimi emergjent dentar i kryer nga shërbimet mjekësore të vendit pritës, si dhe evakuimi me avionë ushtarakë dhe helikopterë do të sigurohet pa pagesë. Megjithatë, kur kërkohet asistencë nga burime të vendit pritës për të transferuar personelin e dëmtuar në një spital ku e zgjedh forca vizitore, por përdoren mjetet e vendit pritës, autoritetet e forcave vizitore do të marrin përgjegjësinë për rimbursimin e kërkuar për shpenzimet e këtij transportimi.

7. Autoritetet e forcave vizitore do t'u bëjnë rimbursimin gjithashtu autoriteteve të vendit pritës në rast evakuimi emergjent me avionë mjekësorë civilë ose helikopterë, si dhe për trajtim më të veçantë mjekësor të personelit të tyre në qendrat mjekësore civile të vendit pritës, me përjashtim se forcat vizitore mund të përfitojnë nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ose bilaterale mbi masat e sigurimit social ose mjekësor për të mbuluar shpenzimet e këtij trajtimi.

Neni 13

Procedurat e hetimit për aksidentet dhe incidentet

1. Mbi bazën e dispozitave të seksionit 8, çdo investigim për aksident ose incident që përfshin personelin e forcave vizitore është përgjegjësi e vendit pritës, por autoritetet e forcave vizitore caktohen të kenë një vëzhgues prezent gjatë hetimit. Vëzhguesi nuk ka lirinë të bëjë hetime ose të marrë pjesë dhe nuk do të jetë prezent, kur hetimi është duke diskutuar mbi të dhënat dhe rekomandimet. Vëzhguesi normalisht nuk është me gradë më lart sesa kryetari i hetimit. Autoritetet e forcave vizitore mund të zhvillojnë investigime të mëtejshme, në rast se mund të kërkohet nga ligjet dhe rregulloret e tyre. Forcat vizitore do të mbulojnë të gjitha shpenzimet që dalin nga pjesëmarrja e tyre në një hetim.

2. Autoriteteve ushtarake të forcave vizitore normalisht u jepen të dhëna dhe rekomandime përkatëse të raportit të aksidentit ose incidentit. Çdo kërkesë për më tepër informacion do të trajtohet nga autoritetet e vendit pritës.

Neni 14

Trajtimi në rast vdekjesh nga forcat vizitore

1. Kur ndodh vdekja e një personi nga forcat vizitore mbi territorin e vendit pritës, kjo i raportohet autoritetit përkatës të vendit pritës. Vdekja do të certifikohet nga një mjek i vendit pritës.

2. Në rast se autoriteti përkatës i vendit pritës kërkon kryerjen e autopsisë, kjo do të bëhet në përputhje me procedurat kombëtare nga një mjek i vendit pritës, i caktuar për këtë qëllim. Gjithashtu mund të jetë prezent në autopsinë, e cila zhvillohet në një vend dhe kohë të caktuar, edhe një doktor i caktuar nga forcat vizitore.

3. Autoritetet e forcave vizitore marrin masat për sistemimin e trupit sapo të merret autorizimi nga autoriteti i vendit pritës. Rikthimi në atdhe i trupit do të bëhet në përputhje me rregullat e vendit

pritës. Autoritetet e forcave vizitore informojnë autoritetet e vendit pritës, në rast se kërkohet, mbi masat e marra për transportimin e trupit nga territori i vendit pritës. Forcat vizitore do të mbulojnë të gjitha shpenzimet që dalin nga kjo kërkesë.

Neni 15
Mbrojtja e mjedisit

1. Procedurat e detajuara për mbrojtjen e mjedisit do të paraqiten, kur është e nevojshme, në masat zbatuese përkatëse. Të gjitha ankesat që lidhen me çështjet e mjedisit do të trajtohen sipas parimeve të përcaktuara në seksionin 10.

Neni 16
Komunikimet

Autoritetet e vendit pritës do të sigurojnë lehtësira për telefon, faks dhe radio të dhëna, të cilat detajohen në masat zbatuese përkatëse.

Neni 17
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij Memorandumi ose të masave zbatuese, do të zgjidhet me negociata ndërmjet Pjesëmarrësve në nivelin e ulët të kërkuar dhe nuk do t'u drejtohen gjykatave kombëtare, ndërkombëtare ose palëve të treta për zgjidhjen.

Neni 18
Amendamentet

Ky Memorandum mund të përmirësohet në çdo kohë, me shkrim me miratimin e përbashkët të Pjesëmarrësve. Ato hyjnë në fuqi datën e firmosjes.

Neni 19
Data efektive dhe përfundimi

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi datën pas marrjes së njoftimit reciprok, në lidhje me përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi. Do të mbetet në fuqi në rast se nuk është përfunduar ose me miratim dypalësh ose nga një Pjesëmarrës, i cili ka bërë njoftimin 6 muaj para me shkrim palës tjetër. Konfirmimi i përfundimit të procedurave do të njoftohet me shkëmbimin e notave diplomatike.

2. Në rast se ky Memorandum ka përfunduar, dispozitat përkatëse për ndonjë çështje të pazgjidhur deri në kohën e përfundimit do të vazhdojnë të aplikohen, si p.sh:

a) Do të mbeten në fuqi deri në përfundimin e të gjitha pagesave të prapambetura në zgjidhjen e ankesave dhe detyrimeve, dispozitat e seksionit 7 (Logjistika dhe financa), 10 (Ankesa dhe detyrimet) dhe 17 (Zgjidhja e mosmarrëveshjes).

b) Dispozitat e seksionit 11 (Mbrojtja dhe sigurimi i informacionit të klasifikuar do të kenë efekt deri kur ky informacion ose është shkatërruar, ose i është kthyer Pjesëmarrësit të origjinës.

Memorandumi i mësipërm përfaqëson mirëkuptimin e arritur ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut lidhur me çështjet të cilat referohen në të.

Firmosur në gjuhën shqipe dhe angleze. Të dy tekstet kanë të njëjtën vlerë.

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 13 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 3, pas fjalëve "Instituti të Sigurimeve Shoqërore" shtohen fjalët "ose Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas fazave, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave".
2. Në pikën 4, fjalët "3 vjetëve" bëhen "5 vjetëve".

Neni 2

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

**"Neni 16
Sanksionet**

1. Kamatëvonesat

Nëse kontributet nuk paguhen në afatet e përcaktuara në këtë ligj, personi juridik e fizik përgjegjës do të paguajë kamatëvonesa, që llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara, nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën pagesa kryhet.

Kamatëvonesa për kontributet e paguara jashtë afateve të caktuara është 2 për qind për muajin e parë të vonesës dhe 1,3 për qind për çdo muaj tjetër.

Kamatëvonesa minimale e zbatuar nuk mund të jetë më e vogël se 5 për qind e detyrimit.

Kamatëvonesat do të deklarohen nga personi juridik ose fizik në deklaratën e muajit pasardhës, kur ka lindur detyrimi dhe do të paguhen brenda datës së përcaktuar për pagesën e kontributeve. Nëse kamatëvonesat nuk deklarohen dhe paguhen në muajin pasardhës, organet e ngarkuara për mbledhjen e kontributeve, lëshojnë një vlerësim për shumën e kamatëvonesës, i cili i njoftohet personit juridik ose fizik.

2. Gjjobat

Kur nuk përbëjnë vepër penale, përveç pagesës së kontributit, shkeljet e mëposhtme dënohen me gjobë:

a) për mosregjistrimin e veprimtarisë ekonomike në organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 60 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar i me gjobë 20 000 lekë;

b) për paraqitjen me vonesë për regjistrimin e veprimtarisë ekonomike në organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 30 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar i me gjobë 10 000 lekë;

c) për vonesë në dorëzimin e dokumentacionit të përcaktuar nga organet përgjegjëse për mbledhjen e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 10 për qind të kontributit të deklaruar me vonesë, por jo më pak se 10 000 lekë, ndërsa i vetëpunësuar i 10 000 lekë;

ç) kur në dokumentacionin e paraqitur ka të dhëna të pasakta për të pakësuar, në këtë mënyrë, shumën e kontributeve, punëdhënësi dënohet me gjobë 50 000 lekë;

d) kur nuk e ka paguar kontributin për sigurimet shoqërore, megjithëse e ka mbajtur nga paga e të punësuarit, punëdhënësi dënohet me gjobë 50 000 lekë;

dh) kur nuk i mban regjistrimet, në përputhje me procedurat e përcaktuara, punëdhënësi dënohet me gjobë 30 000 lekë.

Gjobat vendosen nga inspektorët e agjencive të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Neni 3

Në nenin 68, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja financiare e fondit të sigurimeve shoqërore auditohen një herë në pesë vjet nga subjekte të specializuara në këtë fushë. Zgjedhja e subjekteve bëhet në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik".

Neni 4

Në fund të pikës 1 të nenit 79 bëhen këto shtesa:

"- të dorëzojë në organet e sigurimeve shoqërore, brenda tremujorit të parë të çdo viti, deklaratën për kontributet e paguara gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, për çdo të punësuar, sipas modelit të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

- të marrë numrin e sigurimeve shoqërore nga agjencia e sigurimeve shoqërore për të punësuarit e rinj."

Neni 5

Në nenin 81, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Paragrafi i parë i këtij neni nuk zbatohet për personat juridikë ose fizikë, të cilët veprimtarinë në fushën e kontributeve e kanë kaluar në organet tatimore."

Neni 6

Pika 1 e nenit 82 ndryshohet si më poshtë:

"1. Të gjitha të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe nga kamatëvonesat e tyre, të mbledhura nga organet tatimore, transferohen në llogaritë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të organeve në varësi të tij. Procedurat e transferimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3940, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr.9115, datë 24.7.2003

PËR TRAJTIMIN MJEDISOR TË UJËRAVE TË NDOTURA

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Neni 2

Objekti

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

- a) ujërat e ndotura urbane;
- b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë;
- c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore;
- ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Ujërat e ndotura urbane" janë ujërat e përdorura që shkarkohen nga banesat dhe veprimtaritë e caktuara industriale, të cilat përmbajnë lëndë të tretura dhe lëndë në pezulli.

2. "Ujërat e ndotura shtëpiake" janë ujërat e përdorura të çdo lloji, me përbërje organike, të degradueshme, lëndë minerale në formë të tretur ose në pezulli, të shkarkuara nga instalimet hidraulike të çdo lloji.

3. "Ujërat e ndotura industriale" janë ujërat e përdorura nga veprimtaritë tregtare dhe industriale.

4. "Mjedis pritës" përfaqëson zonat e shkarkimit të ujërave të përdorura.

5. "Aglomerat-zonë urbane intensive" është një zonë ku popullsia dhe veprimtaria ekonomike ka një përqendrim të tillë, i cili bën të nevojshëm që shkarkimet e lëngëta urbane të grumbullohen dhe të sistemohen në një pikë të vetme shkarkimi ose të futen në një impiant trajtimi.

6. "Sistemi kolektor" është sistem kanalizimesh, unik ose i ndarë, që grumbullon dhe sistemon shkarkimet e ujërave të ndotura urbane dhe industriale.

7. "Njëvlerës për popullsinë" është ndotja mesatare e derdhjes për banorë në ditë, që ka 90 gr/ditë lëndë në pezulli, 60 gr/ditë lëndë organike, 15 gr/ditë azot amoniakal dhe 4 gr/ditë fosfor.

8. "Trajtim parësor" është trajtimi i ujërave të përdorura, nëpërmjet procesit fizik me anë të dekantimit parësor, që mënjanon 60 për qind të lëndës në pezulli dhe 20 për qind të NBO5.

9. "Trajtim dytësor" është trajtimi i ujërave të ndotura nëpërmjet procesit biologjik, me shtrat bakterial, basen ajrimi, llum aktiv, duke u shoqëruar, në raste të veçanta, me trajtim tretës (dekantim/filtrim), për realizimin e denitrifikimit dhe defosfatimit.

10. "Trajtim i përshtatshëm" është trajtimi i ujërave të ndotura urbane, nëpërmjet një procesi të dhënë, nga i cili rezulton që shkarkimet e lëngëta në ujërat pritëse nuk dëmtojnë cilësitë e këtyre ujërave, në përputhje me ligjin.

11. "Llum" është mbetja e ngurtë dhe gjysmë e ngurtë, që përftohet gjatë proceseve të trajtimit të ujërave të ndotura.

12. "Eutrofikim" është pasurimi i një ekosistemi ujor me lëndë ushqyese, veçanërisht, me përbërës azoti dhe fosfori dhe me prodhimtari të lartë biologjike, duke shkaktuar një rritje të vrullshme të algave dhe formave të larta të jetës bimore, të shoqëruara me ndryshime të cilësisë së ujit.

13. "Estuar" është zona kalimtare e ujërave sipërfaqësore në grykëderdhjen e lumit në det.

14. "Ujëra bregdetare" janë ujërat jashtë vijës së ujërave të ulëta ose ujërat jashtë kufijve të estuarit.

15. "Nevoja biologjike për oksigjen NBO5" është sasia e oksigjenit të konsumuar gjatë 5 ditëve nga bakteret aerobe në prani të ajrit. Ajo përfaqëson ndotjen organike të biodegradueshme.

16. "Zona të ndjeshme" janë zonat që përfshihen në liqenet natyrore me ujë të ëmbël; ujërat e ëmbla sipërfaqësore, të destinuara për nxjerrjen e ujit të pijshëm; grykëderdhjet, estuaret dhe ujërat bregdetare, të cilat janë përcaktuar si eutrofike, ose vlerësohen të mundshme për t'u bërë të tilla.

17. "Zonat më pak të ndjeshme" janë zonat që përfshihen: në gjiret e hapura, grykat dhe ujërat e tjera bregdetare me një shkëmbim të kënaqshëm të ujërave dhe që nuk janë subjekt ndaj eutrofikimit ose shterimit të oksigjenit, ose vlerësohen të vështira për t'u bërë eutrofike, si pasojë e shkarkimeve të ujërave të ndotura.

18. "Monitorimi" është grumbullimi, vlerësimi dhe përgjithësimi i të dhënave mjedisore me anë të vëzhgimit të vazhdueshëm ose periodik të një grupi treguesish mjedisorë, cilësorë dhe sasiorë, që karakterizojnë përbërësit e mjedisit dhe ndryshimet e tyre nga ndikimi i faktorëve natyrorë ose njerëzorë.

Neni 4

Detyrat e organeve shtetërore

1. Ministria e Mjedisit, agjencitë rajonale dhe Inspektorati i Mjedisit, krahas organeve të ngarkuara me ligj për administrimin e rezervave ujore, ndihmojnë funksionimin e procesit të trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura dhe kontrollojnë zbatimin e tij në të gjitha nivelet.

2. Organet shtetërore, qendrore e vendore, secili në linjën e vet, bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit për:

a) përcaktimin e teknikave, teknologjive dhe metodave më të mira të mundshme për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura, në përputhje me llojin e natyrën e tyre;

b) hartimin e planeve për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura në mënyrë të integruar, si pjesë e planeve të menaxhimit të baseneve ujëmbledhëse përkatëse;

c) krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor, për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe të përdorura;

ç) përsosjen e rrjetit institucional përgjegjës;

d) sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare;

dh) kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive, që shkaktojnë ndotje të ujërave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre.

KREU II

PARANDALIMI I NDOTJES SË UJIT DHE PAKËSIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

Neni 5

Synimet e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura

Procesi i trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura synon:

a) uljen e prodhimit të ujërave të ndotura nga veprimtaritë prodhuese dhe të ngarkesës ndotëse në to;

b) përdorimin e teknikave dhe metodave më të mira të mundshme, të bazuara në kritere mjedisore, të miratuara me një akt normativ;

c) masat mbrojtëse, teknike e teknologjike, domosdoshmërisht të zbatueshme, që prej përdoruesit të tij;

ç) shkurtimin e kohës së ekspozimit të tyre në mjedis;

d) trajtimin e ujërave të ndotura në një fazë të mëparshme, që të mos pengojë përpunimin dhe përdorimin e mëtejshëm të ujërave të ndotura;

dh) pakësimin sa më shumë të lëvizjes së lirë të ujërave të ndotura dhe trajtimin sa më pranë burimit dhe në impiantin më të afërt;

e) parandalimin e ndotjes së mjedisit prej ujërave të ndotura dhe kufizimin e ndikimit kur ajo

ndodh;

ë) dëmshpërblimin për ndotjen dhe rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar që kanë shkaktuar personat fizikë ose juridikë, me shkarkimin e ndotësve në ujëra tej normave të lejuara.

Neni 6

Detyrime të personave fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura

1. Personat fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve shkarkon ujëra të ndotura, detyrohen të marrin masat që:

- a) të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës;
- b) të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme;
- c) të administrojnë dhe të trajtojnë ujërat e ndotura nëpërmjet:
 - i) ndërtimit dhe funksionimit të sistemit të kanalizimeve të brendshme;
 - ii) ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të trajtimit, në përputhje me kërkesat e veçanta, sipas degës së industrisë, së cilës i përket veprimtaria;
 - iii) ndërtimit dhe funksionimit të rrjetit të kanalizimeve, për largimin e ujërave të ndotura urbane dhe të shkarkimeve industriale deri në kolektor;
 - iv) nxitjes së ripërdorimit të dobishëm të ujërave të trajtuara;
 - v) trajtimit të llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga impiantet e trajtimit, sipas kërkesave dhe kushteve të vendosura në lejen mjedisore;
 - vi) zbatimit të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe të metodave e teknologjive bashkëkohore të trajtimit të ujërave të ndotura.

2. Për plotësimin e këtyre detyrimeve, personi fizik ose juridik, veprimtaria e të cilit shkarkon ujëra të ndotura, harton programin e masave teknike, teknologjike e organizative të trajtimit të tyre, i cili kontrollohet nga Inspektorati i Mjedisit, organi që e ka licencuar veprimtarinë dhe nga organet e qeverisjes vendore të zonës.

Neni 7

Detyrimet e trajtuesve të ujërave të ndotura

1. Personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, që marrin përsipër trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura, sigurojnë:

- a) zbatimin e kërkesave teknike, metodike dhe organizative për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;
- b) zbatimin e kushteve dhe të kërkesave, të përcaktuara në lejen mjedisore;
- c) shkarkimin e ujërave të trajtuara në mjedisin pritës vetëm kur ato janë brenda normave të lejuara;
- ç) trajnimin e stafit që merret me impiantet dhe instalimet e trajtimit e të pastrimit të ujërave të ndotura;
- d) hartimin dhe administrimin e dokumentacionit, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e proceset që kryhen për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;
- dh) mbajtjen e regjistrave të veçantë, sipas ndarjes dhe klasifikimit të ujërave të ndotura, për sasinë, përmbajtjen dhe pastrimin e këtyre ujërave;
- e) trajtimin e llumrave dhe të lëndëve të ngurta, që dalin nga pastrimi i ujërave, sipas kërkesave të administrimit të mbetjeve të ngurta;
- ë) lehtësimin e kontrollit të inspektorëve;
- f) kontratat me personat fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, veprimtaritë e të cilëve krijojnë ujëra të ndotura, duke përcaktuar me hollësi detyrimet përkatëse.

2. Trajtuesit e ujërave të ndotura janë përgjegjës për dëmet që shkaktojnë në shëndet dhe në mjedis. Ata janë të detyruar të dëmshpërblejnë për ndotjen dhe të rehabilitojnë mjedisin me shpenzimet e veta. Rregullat dhe procedurat për vlerësimin e dëmit dhe rehabilitimin e mjedisit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mjedisit.

KREU III

TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA SIPAS LLOJIT

Neni 8

Trajtimi i ujërave të ndotura industriale

1. Çdo subjekt, veprimtaria e të cilit krijon ujëra të ndotura industriale, i trajton ato në përputhje me veçoritë e degëve të industrisë.
2. Trajtimi i ujërave të ndotura industriale është një proces ku përfshihen:
 - a) trajtimi paraprak nga veprimtaria që i krijon;
 - b) trajtimi nga personat fizikë dhe juridikë, që marrin përsipër pastrimin e tyre, nëpërmjet vendosjes dhe vënies në funksionim të impianteve të trajtimit;
 - c) ndalimi i ripërdorimit të ujërave industriale të trajtuara;
 - ç) ndalimi i përdorimit të llumrave të mbetura pas procesit të pastrimit të tyre;
 - d) depozitimi përfundimtar i mbetjeve të ngurta në vende të caktuara.
3. Në përfundim të trajtimit, sipas degëve të industrisë, ujërat e përdorura, kur janë brenda normave të lejuara të purifikimit, shkarkohen vetëm në ujëra sipërfaqësore rrjedhëse.
4. Shkarkimet e lejuara për çdo njësi prodhuese ose objekt (projekt) industrial, parashikohen që në fazën projektuese dhe pasqyrohen në raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), të paraqitur nga propozuesi.

Neni 9

Shkarkimet e lëngëta në zonat industriale

1. Në zonat industriale, për trajtimin e shkarkimeve të lëngëta, ndërtohen disa impiante, në përputhje me kapacitetet dhe veçoritë e degëve të ndryshme të industrisë që veprojnë në atë zonë (impiante të precipitimit kimik, për të trajtuar mbetjet e metaleve toksike, impiante të trajtimit biologjik, për të trajtuar mbetjet organike).
2. Llumrat dhe pezullitë të trajtohen për t'u minimizuar dhe, nëse ka prani të metaleve toksike, ato të zhduken me metoda të përshtatshme.

Neni 10

Shkarkimet e lëngëta të një procesi të çfarëdollojshëm

Shkarkimet e lëngëta, si rezultat i filtrimeve të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, nga veprimtaritë bujqësore ose nga një proces tjetër i çfarëdollojshëm, nuk duhet të kalojnë nivelet e normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta të një procesi çfarëdo.

Neni 11

Trajtimi mjedisor i ujërave të ndotura urbane

1. Shkarkimet urbane i nënshtrohen trajtimit mjedisor paraprak, i cili përfshin:
 - a) ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për lëvizjen e ujërave të ndotura nga banesat drejt rrjetit të kanalizimeve urbane;
 - b) ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të kanalizimeve të shkarkimeve të lëngëta, në zonat urbane dhe rurale, duke respektuar kriteret e mbrojtjes së mjedisit. Këshilli i Ministrave miraton kriteret mjedisore të ndërtimit dhe të funksionimit të sistemit të kanalizimeve, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe Ministrit të Shëndetësisë;
 - c) në rastet kur rrjeti i kanalizimit nuk mund të ndërtohet, vendosen sisteme të tjera, që garantojnë mbrojtjen e mjedisit;
 - ç) trajtimin e tyre të ndarë nga shkarkimet e tjera të lëngëta;
 - d) ndërtimin dhe funksionimin e impianteve të trajtimit të tyre para shkarkimit në ujërat

sipërfaqësore;

dh) shkallën e trajtimit të tyre, e cila duhet të jetë në lidhje të ngushtë me veçoritë e mjedisit pritës, ku ujërat e trajtuara urbane shkarkohen përfundimisht.

2. Kërkesat e pikës 1 të këtij neni janë të detyrueshme si për zonat urbane intensive dhe për ato jointensive.

3. Zonat turistike ekzituese dhe ato me zhvillim të pritshëm të turizmit pajisen me sistem kolektor (kanalizimesh) të shkarkimeve të lëngëta urbane.

4. Për shkarkimet e lëngëta urbane zbatohen normat kufi të lejuara.

Neni 12

Trajtimi i ujërave të ndotura urbane

Shkarkimet e lëngëta urbane i nënshtrohen një trajtimi të rreptë, veç trajtimit parësor e dytësor dhe, në raste të veçanta, edhe trajtimit purifikues përkatës.

Neni 13

Trajtimi i ujërave të ndotura urbane në zonat më pak të ndjeshme

1. Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat më pak të ndjeshme u nënshtrohen procedurave të trajtimit parësor, me kusht që të mos ketë rritje të ndikimeve negative në mjedisin pritës.

2. Nëse Inspektorati i Mjedisit vëren se ka dhe vazhdon të ketë ndikime negative në mjedisin pritës, urdhëron trajtimin dytësor të shkarkimeve të lëngëta urbane.

Neni 14

Identifikimi dhe miratimi i zonave

1. Identifikimi i zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme bëhet jo më rrallë se një herë në 4 vjet.

2. Miratimi i zonave të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

Neni 15

Shkarkimet në zonat malore

Shkarkimet e lëngëta urbane në zonat malore, për arsye të temperaturave të ulëta, ku është i vështirë të zbatohet impianti i trajtimit biologjik, i nënshtrohen trajtimit fiziko-kimik, me kusht që të mos rriten ndikimet negative në mjedis.

Neni 16

Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta

1. Në normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta përfshihen:

- a) normat e lejuara të shkarkimeve industriale;
- b) normat e lejuara të shkarkimeve të zonave industriale;
- c) normat e lejuara të shkarkimeve të një procesi çfarëdo;
- ç) normat e lejuara të shkarkimeve urbane.

2. Normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit dhe të ministrave përkatës.

Neni 17

Rehabilitimi i mjedisit pritës

Kur Inspektorati i Mjedisit vëren tejkalime të normave të lejuara të shkarkimeve të lëngëta në

mjedisin pritës, urdhëron ndërprerjen e shkarkimeve të mëtejshme, deri në rehabilitimin e mjedisit të ndotur dhe respektimin e normave.

KREU IV LEJA MJEDISORE

Neni 18

Kushtet e lejes mjedisore

1. Në lejen mjedisore të personave fizikë ose juridikë, veprimtaritë e të cilëve krijojnë ujëra të ndotura, përcaktohen:

a) kushtet e veçanta për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta në pajtim me llojin e veprimtarisë;

b) kërkesat për ndërtimin dhe funksionimin e rrjetit të brendshëm të kanalizimeve;

c) kërkesat për trajtimin parësor të ujërave të përdorura;

ç) masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit prej tyre;

d) kolektorin ku duhet t'i shkarkojnë ujërat e trajtuara dhe regjimin e shkarkimit të tyre;

dh) mbajtjen e regjistrave;

e) kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

2. Personat fizikë dhe juridikë, që marrin përsipër trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura, pajisen me leje mjedisore përkatëse, në të cilën kanë të përcaktuar:

a) kërkesat dhe kushtet e vendit të ndërtimit të impianteve dhe instalimeve për pastrimin e ujërave;

b) llojin e impiantit ose impianteve që do të përdorin;

c) metodat, teknikat dhe teknologjitë, që përdor impianti dhe rregullat e funksionimit të tij;

ç) normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta, që duhet të plotësojnë ujërat pas trajtimit;

d) mjedisin pritës ku do të derdhen ujërat e pastruara dhe regjimin e derdhjes së tyre;

dh) kërkesat për trajtimin mjedisor të llumrave, që rezultojnë nga trajtimi i ujërave të ndotura, në përputhje me natyrën, përbërjen dhe sasinë e tyre;

e) mbajtjen e regjistrave;

ë) kryerjen e monitorimit dhe publikimin e rezultateve të tij.

Neni 19

Përfshirja nga tarifa

Personat fizikë dhe juridikë, që realizojnë trajtimin e ujërave të ndotura, përfshihen nga tarifa e shërbimit për pajisjen me leje mjedisore.

KREU V MONITORIMI

Neni 20

1. Personat fizikë dhe juridikë, veprimtaritë e të cilëve shkarkojnë ujëra të ndotura, si dhe ata që kanë marrë përsipër trajtimin e shkarkimeve të lëngëta urbane, shtëpiake, industriale dhe të çfarëdo procesi, organizojnë dhe realizojnë, me shpenzimet e veta, monitorimin e këtyre veprimtarive.

2. Për realizimin e monitorimit, personat fizikë dhe juridikë specializojnë punonjës të tyre ose kontraktojnë me institute të specializuara, të angazhuara në realizimin e Programit Kombëtar të Monitorimit.

3. Monitorimit i nënshtrohen të gjitha fazat e trajtimit të shkarkimeve të lëngëta, përfshirë dhe mjedisin pritës.

4. Monitorimi i veprimtarisë vetjake realizohet në përputhje me kërkesat e Programit Kombëtar të Monitorimit, si dhe në bazë të programit individual të monitorimit, të cilin personi fizik ose juridik e paraqet bashkë me kërkesën për t'u pajisur me leje mjedisore.

5. Programi individual përfshin:

- a) përcaktimin e metodave bashkëkohore në përputhje me veçoritë e shkarkimeve të lëngëta;
- b) përcaktimin e frekuencës së matjeve dhe të pikave të marrjes së mostrave, në përputhje me madhësinë e impiantit të trajtimit dhe veçoritë e mjedisit pritës.

KREU VI KONTROLLI

Neni 21

1. Inspektorati i Mjedisit, organi që ka lincencuar veprimtarinë, inspektorati sanitar dhe inspektorati bashkiak ushtrojnë kontrolle për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta.
2. Inspektorati i Mjedisit kontrollon zbatimin e rregullave dhe të kërkesave për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura dhe kushtet e vendosura në lejen mjedisore.

KREU VII SANKSIONET

Neni 22

Veprime të ndaluara

Në territorin e Republikës së Shqipërisë ndalohen:

- a) shkarkimi në tokë ose në ujëra sipërfaqësore i ujërave të ndotura përtej limiteve, që përcaktojnë normat e lejuara për shkarkimet e lëngëta;
- b) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura jashtë vendeve të përcaktuara për këtë qëllim;
- c) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura nga personat fizikë e juridikë, të palicencuar për këto veprimtari;
- ç) trajtimi dhe pastrimi i ujërave të ndotura me teknika dhe teknologji të papërshtatshme dhe të pamiratuara me një akt normativ;
- d) përzierja me ujëra sipërfaqësore i shkarkimeve të lëngëta të venddepozitimeve të mbetjeve të ngurta, si dhe të dampave;
- dh) përdorimi i ujërave të ndotura për çdo qëllim ose veprimtari.

Neni 23

Kundërvajtjet administrative

1. Kur shkeljet e kërkesave të këtij ligji përbëjnë vepër penale, sipas kreut “Vepra penale kundër mjedisit” të Kodit Penal, Inspektorati i Mjedisit bën kallëzim për ndjekje penale.
2. Shkeljet e kërkesave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative, për rastet si më poshtë:
 - a) ushtrimi, pa leje mjedisore, i veprimtarive me shkarkime të lëngëta në mjedis, si dhe i veprimtarive për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;
 - b) mosrespektimi i kushteve dhe kërkesave të vendosura në lejet mjedisore për administrimin mjedisor të ujërave të ndotura e të përdorura;
 - c) moskryerja e trajtimit parësor të shkarkimeve të lëngëta nga veprimtaritë që shkarkojnë ujëra të ndotura;
 - ç) shkarkimet e pakontrolluara të ujërave të ndotura, kur nuk ka sisteme kanalizimesh brenda territorit të veprimtarisë, kur nuk ka sisteme të tilla nga veprimtaria deri në kolektor ose kur këto sisteme nuk funksionojnë;
 - d) mosinstalimi dhe mosvënia në punë e impianteve të trajtimit të shkarkimeve të lëngëta, brenda veprimtarisë që shkarkon ujëra të ndotura, si dhe në veprimtaritë që kanë marrë përsipër trajtimin dhe pastrimin e këtyre ujërave;
 - dh) shkelja e kërkesave dhe e rregullave për funksionimin e impianteve dhe të instalimeve për trajtimin dhe pastrimin e ujërave të ndotura;
 - e) mosmbajtja e regjistrit të shkarkimeve të lëngëta;
 - ë) moskryerja e procesit të monitorimit;

- f) mosdhënia e informacionit dhe mospublikimi i të dhënave të monitorimit;
- g) mosvënja në dijeni e popullatës për ndotjen e ujërave, për rreziqet e mundshme në shëndet dhe për masat mbrojtëse që duhen marrë në rastet e shkarkimeve tej normave të lejuara.

Neni 24

Masat e gjobës për kundërvajtjet administrative dhe sanksione të tjera

1. Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, Inspektorati i Mjedisit jep dënime me gjobë:

- a) për shkronjat "e", "ë", "f" dhe "g" nga 100 000 deri në 300 000 lekë;
- b) për shkronjat "a", "b", "c" dhe "dh" nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
- c) për shkronjat "ç" dhe "d" nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, Inspektorati i Mjedisit mund të vendosë mbylljen e përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit të shkaktuar.

3. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative bëhet në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", i ndryshuar.

Neni 25

Ankimi

1. Kundër vendimit të Inspektoratit të Mjedisit mund të bëhet ankim te Ministri i Mjedisit brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit. Ministri i përgjigjet ankimit brenda 15 ditëve nga depozitimi i tij.

2. Kundër vendimit të Ministrit të Mjedisit ose kur ky i fundit nuk përgjigjet brenda afatit 15-ditor, mund të bëhet ankim brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit në gjykatën e rrethit ku është bërë kundërvajtja.

Neni 26

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11 pika 1 shkronja "b", 14 pika 2 dhe 16 pika 2 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas miratimit të tyre nga Kuvendi.

2. Ngarkohet Ministri i Mjedisit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, brenda 3 muajve pas miratimit të tyre nga Kuvendi.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3941, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J

Nr.9116, datë 24.7.2003

PËR FALJEN E GJOBAVE DHE TË INTERESAVE PËR DETYRIMET TATIMORE TË TVSH-SË, TË PASHLYERA NGA KONTRAKTORËT E PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA PROGRAMI "PHARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Falen të gjitha gjobat e vëna dhe interesat e zbatuar për detyrimet tatimore të TVSH-së, të pashlyera nga kontraktorët e projekteve të financuara nga programi "PHARE", sipas listës që i bashkëlidhet këtij ligji.

Firmave që nuk kanë shlyer detyrimet tatimore të TVSH-së, nuk u falen gjobat e interesat pa shlyer detyrimet e papaguara.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3942, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

PASQYRA E DETYRIMEVE TË KONTRAKTORËVE QË OPEROJNË NË NDËRTIMIN DHE
REHABILITIMIN E RRUGËVE

Në lekë

EMRI	NIPT	DETYRIMI	INTERESA	GJOBA	SHUMA
GRANIT	J91516004J	0	37900794	9788997	47689791
BE-HA-SE	J91417006 E	7889124	70696399	70550471	149135994
SA-FA	J81412002 P	29988250	7077260	14720525	51786035
MAVROVO	J91511008 Q	0	0	9485694	9485694
ITAL STRADE	J91613001 T	0	0	9657531	9657531
CONSTRFALCIONE	J61826103 R	0	0	69908	69908
RUSC TURB SIDER	J91427007 Q	6135425	1039522	6237433	13412380
SHUMA		44012799	116713975	120510559	281237333

Shënim: Këto të dhëna i referohen datës 24 janar 2003

L I G J
Nr.9117, datë 24.7.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË
PRIVATIZIMIT TË "ARMO" SHA, FIER**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Shoqëria anonime "Armo" i nënshtrohet privatizimit.

Neni 2

Forma e privatizimit të "Armo" sha, Fier, të jetë ajo e transferimit tek të tretët të të drejtës së pronësisë së aksioneve të kapitalit të shoqërisë, nëpërmjet formave të parashikuara në këtë ligj, ose nëpërmjet transferimit të të drejtave të përdorimit dhe të zhvillimit të aseteve të shoqërisë me kontratë koncesioni, sipas formave të parashikuara në ligjin nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime dhe infrastrukturë", i ndryshuar.

Neni 3

Këshilli i Ministrave përcakton formën e privatizimit në përputhje me nenin 2 të këtij ligji dhe vendos për transferimin tek të tretët të aksioneve të kapitalit ose të transferimit të të drejtës së përdorimit dhe të zhvillimit për shoqërinë në tërësi ose për veprimtari të veçanta, duke përcaktuar garancinë kohore për përpunimin e naftës së prodhuar nga kompanitë vendase të paktën për pesë vjet.

Neni 4

Struktura e formulës së privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë "Armo" sha, Fier, në rastin e transferimit të të drejtës së pronësisë, të jetë:

1. Jo më pak se 51 për qind e aksioneve të kapitalit u ofrohen për transferim investorëve strategjikë, nëpërmjet shitjes me tender të hapur ndërkombëtar.

Pagesa e kësaj pakete të aksioneve të bëhet me para.

2. Ish-pronarëve të truallit u ofrohen aksione sipas vlerës së truallit të përfshirë në kapitalin e shoqërisë, siç përcaktohet në vendimet nr.169, datë 13.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe të shitjes së trojeve të ndërmarrjeve shtetërore që i nënshtrohen privatizimit ose transformimit të tyre në shoqëri tregtare"; nr.119, datë 18.3.2000 "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë" dhe nr.119, datë 27.2.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.119, datë 18.3.2000 "Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë".

3. Punonjësve të shoqërisë "Armo" sha Fier, u ofrohen aksione në kapitalin e shoqërisë në shkëmbim të bonove të privatizimit, që u janë dhënë nga shteti.

Punonjës të "Armo" sha, Fier janë punonjësit, të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune të pandërprera, që nga krijimi i shoqërisë deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe ata që e kanë fituar këtë status me akte të tjera ligjore e nënligjore.

4. Investorët strategjikë, që do të blejnë aksione, sipas pikës 1 të këtij neni, kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve të mbetura, nëse ka, pas procedurës së përshkruar më sipër, duke paguar të njëjtin çmim për aksion, sa është paguar për aksionet sipas pikës 1. Kjo e drejtë zgjat një vit pas plotësimit të procedurës së transferimit të aksioneve të ofruara subjekteve, sipas pikave 1 dhe 2.

5. Nëse investitori strategjik nuk e ushtron të drejtën e parablerjes, sipas pikës 4 të këtij neni, pjesa e mbetur e aksioneve, nëse ka, pas procedurës së përshkruar më sipër, me vendim të Këshillit të Ministrave, do të transferohet me ofertë publike dhe/ose me ankand publik.

Për qëllimet e nenit 4, nenet 206 dhe 207 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", nuk zbatohen.

Neni 5

Punonjësve të "Armo" sha, Fier, të punësuar për një periudhë jo më pak se dy vjet, të cilët do të dalin të papunë, t'u jepet nga shoqëria e privatizuar, deri një vit pas privatizimit të shoqërisë, një pagesë e barabartë me pagën e dy viteve dhe t'u paguhen kontributet e papaguara të sigurimeve shoqërore.

Punonjësve të "Armo" sha, të punësuar për një periudhë më pak se dy vjet, t'u jepet një pagë e barabartë me kohën e punësimit në këtë shoqëri.

Neni 6

Mënyra e përdorimit të të ardhurave, që do të përfitohen nga privatizimi i shoqërisë "Armo" sha, Fier përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit për Buxhetin e Shtetit.

Neni 7

Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, që, me asistencën e shoqërisë konsulente ndërkombëtare, të ndjekin dhe të organizojnë kryerjen e procedurave për privatizimin e shoqërisë, në zbatim të këtij ligji.

Neni 8

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për realizimin e procesit të privatizimit të shoqërisë "Armo" sha, Fier.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3943, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J **Nr.9119 datë 24.7.2003**

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7697, DATË 7.4.1993 "PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7813, DATË 14.4.1994, LIGJIN NR.7927, DATË 24.4.1995 DHE LIGJIN NR. 8343, DATË 6.5.1998

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative", ndryshuar me ligjin nr.7813, datë 14.4.1994, ligjin nr. 7927, datë 24.4.1995 dhe ligjin nr. 8343, datë 6.5.1998 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 3 ndryshohet si më poshtë:

"Kanë të drejtë të nxjerrin akte që parashikojnë kundërvajtje administrative edhe këshillat e bashkive dhe të komunave, për shkelje që kanë lidhje me fushat, ku sipas ligjit ushtrojnë funksionet e veta e të përbashkëta në njësitë territoriale përkatëse dhe që nuk janë parashikuar si të tilla në ligje të veçanta."

Neni 2

Neni 5 i ligjit ndryshohet si më poshtë:

"Neni 5

Niveli i dënimit me gjobë dhe gjoba në vend në rastet e shkeljeve të një rëndësie të vogël, për kundërvajtjet e parashikuara në aktet e bashkisë dhe të komunës, përcaktohen me vendim të këshillit përkatës."

Neni 3

Neni 6 i ligjit shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i parë shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"kundërvajtje të miratuara nga organet kolegjiale të njësive vendore kalojnë 100 për qind në favor të buxhetit të pavarur të bashkisë dhe komunës."

2. Paragrafi i tretë shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"70 për qind sipas kriterëve që përcakton këshilli përkatës për administrimin e të ardhurave që realizojnë bashkia dhe komuna."

Neni 5

Çdo akt ligjor dhe nënligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3945, datë 19.8.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit "Sistemim, asfaltim rruge qendër qyteti në drejtim të varrezave, sistemim, asfaltim rruge ndërmjet dy shkollave, vendosje e lapidarit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në Bashkinë Bilisht".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Bilisht. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I SISTEMIM, ASFALTIM
RRUGE QENDËR QYTETI NË DREJTIM TË VARREZAVE, SISTEMIM ASFALTIM RRUGE
NDËRMJET DY SHKOLLAVE, VENDOSJE E LAPIDARIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE
NACIONALÇLIRIMTARE, NË BASHKINË BILISHT".

Nr.	Emri mbiemri	Sip.toke(m ²)	Njësia(Lek m ²)	Vlera (Lekë)
1	Trashëgimtarët e Refat Nallbatit Shadie Refat Nallbati Alije Osman Spaho Ylver Raif Noke Pranvera Raif Noke Fatmir Hysen Nallbati Zhuljeta Nallbati Mirela Skënder Nallbati Budjon Skënder Nallbati Firdes Hysen Nallbati Ritvan Hysen Nallbati Yllkë Fetri Nallbati Rudi Feti Nallbati Pëllumb Feti Nallbati Viktori Nallbati Dritan Fejzi Nallbati Monika Fejzi Nallbati Romeo Fejzi Nallbati Fredri Fejzi Nallbati Fiqiri Zenel Nallbati Nexhat Zenel Nallbati Refiko Zenel Nallbati	608 m ²	100	608 000
2	Trashëgimtarët e Rushan Ajçes Esma Ajçe Ismail Rushan Ajçe Niko Rushan Ajçe Përparim Rushan Ajçe	139.5	1000	139 500
3	Ymer Ramadan Shurdho	37	1000	37 000
4	Nexhip Xhevair Bregu	315	100	315 000
5	Trashëgimtarët e Neki Skotit Merjeme Skoti Luan Neki Skoti Ferdane Neki Skoti Silvana Neki Skoti	30	1000	30 000
			Shuma	1 129 500 lekë

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

Doli nga shtypi më 22.9.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë